



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion, Mandate,

Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen

e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Mbledhja nr. 16

Prishtinë, më 14.4.2015, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-2

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit

Në mbledhje morën pjesë: Albulena Haxhiu, Selvie Halimi, Danush Ademi, Agim Aliu, Doruntinë Maloku, Armend Zemaj, Agim Ademaj, Nezir Çoçaj dhe Donika Kadaj-Bujupi.

Munguan: Fatmir Limaj dhe Milena Miliqeviq.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Zahir Çerkini-praktikant në Kuvend, Armend Krasniqi-ANJF, Ramadan Gashi-ANJF, Petrit Hysaj-OSBE, Valdet Hajdini-IKD, Artan Cahani-KDI, Dibran Istrefi-Klan Kosova, Florina Merovci-ZPRK, Gentiana Begolli-Pustina-RTK, Valmire Hoti-Infodirekt.tv, Bletë Bejtullahu-EUSR/EU Office, Dardane Neziri-Koha Ditore dhe Avni Bytyçi-GLPS.

Nga Stafi i Komisionit: Visar Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi, Albulena Haxhiu, kryetare e Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 9.3.2015;
3. Shqyrtimi i raportit vjetor të punës së Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas, për vitin 2014;

4. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit Penal të Republikës së Kosovës nr. 04/L-082;
5. Caktimi i një përfaqësuesi në Komisionin qeveritar për njohjen e statusit të ish-të dënuarve dhe të ish- të përndjekurve politikë;
6. Shqyrtimi i raporteve të Komisioneve Kryesore për Projektligjin për Mbikëqyrjen Elektronike të personave të cilëve u kufizohet lëvizja me vendim të Gjykatës ose të Panelit për lirim më kusht;
7. Shqyrtimi i raporteve të Komisioneve Kryesore për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-51, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik;
8. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Kryetarja konstatoi se rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i Procesverbaleve nga mbledhja e mbajtur më 9.3.2015;

Kryetarja konstatoi se Komisioni miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 9.0.2015, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i raportit vjetor i punës së Agjencisë për ndihmë juridike falas, për vitin 2014;

Albulena Haxhiu, kryetare, theksoi se Agjencia për Ndihmë Juridike Falas është institucion mjaftë i rëndësishëm i vendit, që mundëson qasje të barabartë në drejtësi të qytetarëve. Ajo tha se raporti që ka sjellë ky institucion ka shumë përshkrime ligjore. Ajo theksoi se ka pasur nevojë për detaje në raport sidomos sa i përket lëndëve. Buxheti me të cilin operon agjencia është tejet i ulët. Gjithashtu mungesë në raport është edhe numri i rasteve që janë zgjidhur në favor të palëve, ngase vetëm në këtë mënyrë mund ta dimë cilësinë e punës së agjencisë. Fushata njoftuese për qytetarët dhe qëndrimi në objekte private mbetët një tjetër shqetësim sa i përket agjencisë, tha Haxhiu.

Armend Krasniqi theksoi se për agjencinë paraqet problem funksionimi në prona private dhe qiraja që duhet paguar për to. UNDP-ja ka ndërprerë programin për të mbuluar kontratat e punëtorëve të agjencisë, por Ambasada Norvegjeze e ka bërë këtë mbulim përmes grandeve të tyre.

Ramadan Gashi theksoi se pjesa përshkruese e raportit ka ardhur si rezultat i sugjerimeve të zyrës koordinuese të të gjitha agjencive, andaj është vendosur kjo për herë të parë. Lëndët i kemi

vendosur në mënyrë tabelore, pa bërë përshkrim tekstual. Gjithashtu në raport kemi paraqitur edhe tarifën më të cilën operojnë zyrtarët e agjencisë. Zyrtarët e agjencisë kanë kompetencë në lëndë deri tek përfaqësimi në gjykatë, ku përfaqësimin e bënë avokati, të cilin në bazë të marrëveshjes me Odën e Avokatëve e angazhon agjencia.

Sfidë e agjencisë është shtrirja e saj në nivel vendi. Kërkojmë ndihmën nga Komisioni juaj që të gjendet buxhet edhe për dy zyra regjionale, ngase vetëm pesë i kemi të mbuluara.

Ne jemi duke pritur mbështetje nga ana e Ambasadës Holandeze, për të bërë fushatë për vetëdijësim për punën e agjencisë. Konsiderojmë se rreth 70% e popullatës janë të kualifikuar për ta marrë ndihmën juridike falas. Ende si agjenci nuk kemi arrit të marrim raporte nga avokatët se sa kanë qenë efikas në përfaqësimin e lëndëve që i kanë marrë nga agjencia, në gjykata. Ne kemi bërë një kërkesë për të kaluar në hapësira publike, në mënyrë që të kursehet një buxhet rreth 30.000 euro, dhe ato mjete të alokohen për avokatët.

Kryetarja Albulena Haxhiu, theksoi se çdo vit tjetër kemi pas një raport më të detajuar sesa ky që e kemi tash, dhe se për vite me radhë kemi kërkuar një shifër të saktë se sa kanë qenë rastet e fituara në dobi të palës, e që kanë kaluar përmes agjencisë, dhe asnjëherë nuk e kemi marrë një gjë të tillë.

Donika Kadaj-Bujupi theksoi se është një dështim i agjencisë që nuk mund të informojë në lidhje me rastet e fituara në favor të palëve, aq më shumë kur vet e pranoni se nuk keni arritur as të gjeni koordinim me avokatet për të marrë një shifër të saktë.

Kadaj-Bujupi theksoi edhe çështjen se sa është numri i grave që kanë kërkuar ndihmë dhe sa ka qenë kjo efikase, siç janë rastet e divorcit dhe pyeti se a kanë kontaktuar me komunat sa i përket zyrës, ngase mund të gjejnë një zgjidhje atje.

Armend Zemaj tha se është e rëndësishme që të bëhet fushatë vetëdijësuese për punën e agjencisë, në mënyrë që qytetarët të dinë më shumë për të, dhe në këtë mënyrë të arrijnë ta shfrytëzojnë këtë të drejtë.

Zemaj theksoi se do të ishte mirë të bëhet një memorandum mirëkuptimi në mes këtij institucioni dhe Odës së Avokatëve, të dimë se cilët avokatë janë të angazhuar, dhe në këtë mënyrë të përcillet cilësia, respektivisht puna e tyre. Andaj, duhet ditur se sa është efikasiteti i punës së këtij institucioni, karshi palëve që e gëzojnë këtë të drejtë.

Selvije Halimi, theksoi se do të ishte mirë po të kishim shifra dhe rezultate të punës suaj, respektivisht të efikasitetit të zyrtarëve tuaj, duke përfshi këtu edhe bashkëpunimin me avokatët, në mënyrë që ne të kemi një pamje të qartë të punës së agjencisë, dhe në këtë mënyrë të kemi bazë për të kërkuar mbështetje për ju. Gjithashtu do të ishte mirë të kemi edhe informata për punën e avokatëve, në formë raportesh, apo në ndonjë mënyrë tjetër me qëllim të mbajtjes nën kontroll dhe llogari të tërë procesit.

Agim Aliu theksoi se duhet të angazhohemi vazhdimisht që qytetarët tanë të arrijnë të kuptojnë që e kanë një të drejtë për përfaqësim falas, dhe se ajo e drejtë realizohet përmes kësaj agjencie, në këtë mënyrë do të mund të arrihej të ushtrohet kjo e drejtë.

Gjithashtu, ai theksoi se do të bëjmë atë çka duhet për të forcuar pozicionin e agjencisë, në veçanti kur jemi tek buxheti dhe hapja e zyrave të reja regjionale.

Nezir Çoçaj theksoi se sa i përket shtimit të kapacitetit profesional, do të ishte mirë të bashkëpunohet me universitete publike brenda Kosovës, respektivisht me fakultetin juridik të tyre, në mënyrë që të arrihen përfitime të dyanshme, duke e pas parasysh që ato mbahen nga taksat e qytetarëve të vendit.

Agim Ademaj tha se do të ishte mirë që në raport të ishin përfshirë të dhënat se sa lëndë janë fituar, ose në cilën fazë të shqyrtimit janë. Ai foli edhe për buxhetin e agjencisë, duke shprehur gatishmërinë për të kërkuar mjete shtesë që të ekzistojë agjencia dhe puna e saj si e tillë.

Danush Ademi foli për përfitimet që kanë pasur komunitetet joshumicë në vend nga ana e agjencisë, përmes të cilës kanë gjetur mbështetje juridike. Ai theksoi se do të ishte mirë që në Ferizaj të hapet një zyrë e këtij institucioni, për faktin që në atë komunë jeton një numër i madh i komuniteteve joshumicë, andaj do të ishte ndihmë për ta që një zyrë të jetë më afër tyre.

Armend Krasniqi theksoi se në lidhje me numrin e lëndëve dhe sqarimet rreth tyre në raport ka mungesa dhe se pajtohen me këtë, por që gjatë hartimit të tij i është përmbajtur një shablloni dhe nuk është lëvizur nga ai.

Krasniqi diskutoi në lidhje me bashkëpunimin në mes agjencisë dhe Odës së Avokatëve, duke vënë në pah punën që bëjnë avokatët dhe kompensimi i tyre në bazë të tarifës së përcaktuar nga ana e agjencisë, edhe pse, tarifat e Odës janë më të larta. Duke e pas parasysh që në kuadër të Odës së Avokatëve, çdo avokat është i obliguar që ta marrë një rast “pro bono”, nëse kjo gjë ndodhë, atëherë do të ndihmohej agjencia me një gjë të tillë. Angazhimi i avokatëve për përfaqësim bëhet vetëm për rastet civile, ndërsa për raste penale agjencia jep vetëm këshilla juridike.

Ramadan Gashi theksoi se sa i përket vitit 2014, janë angazhuar 308 avokatë, që do të thotë, 308 procedura, dhe të gjitha janë në procedurë, asnjë lëndë nuk ka marrë zgjidhje. Për këtë arsye nuk kemi mundur të sigurojmë shifra për kryerjen efikase të lëndëve.

Sa i përket shërbyesve civilë, të gjithë kanë kontrata, por në mungesë të stafit, kemi zyrtarë që kryejnë dy e me tepër pozita në përputhje me ligjin.

Sa i përket zyrave në terren, në kemi llogaritur që komunat do t’na ofrojnë zyrë, nëse ne e kemi zyrtarin për atë, andaj nevojitet buxhet shtesë për të angazhuar zyrtarë.

Sa i përket fushatës reklamuese, UNDP-ja e ka ndihmuar agjencinë për të gjitha reklamat, ndërsa tash jemi duke pritur një mbështetje nga ana e Ambasadës së Holandës.

Albulena Haxhiu, kryetare, tha se kur parashtruam pyetje në lidhje me shifrat se sa raste janë fituar në favor të palëve, e që kanë qenë të përfaqësuara nga ana e agjencisë, nuk ishte fjala që shembull, prej 300 rasteve të jenë 200 e ca të fituara. Por, nëse prej atij numri, janë vetëm 10 sosh, atëherë këtu kemi probleme të mëdha me përfaqësimin, andaj kërkojmë nga ju që ta informoni komisionin për rastet e fituara.

Sa i përket buxhetit, Haxhiu theksoi se është shumë e padrejtë që është ndarë për agjencinë dhe se, kjo është në s'përputhje të plotë me numrin e qytetarëve që e gëzojnë të drejtën për ndihmë juridike falas, e që arrijnë në 70%.

Pas diskutimeve, Komisioni vendosi që raporti me rekomandime për Kuvend të votohet në mbledhjen e radhës.

4. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit Penal të Republikës së Kosovës nr. 04/L-082;

Albulena Haxhiu, kryetare, njoftoi anëtarët e Komisionit se është pranuar një shkresë nga ana e Ministrisë së Drejtësisë, me anë të së cilës njoftohet se është tërhequr Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit Penal të Republikës së Kosovës nr. 04/L-082, dhe nuk ka nevojë të diskutohet në këtë mbledhje.

5. Caktimi i një përfaqësuesi në Komisionin qeveritar për njohjen e statusit të ish-të dënuarve dhe të ish- të përndjekurve politikë;

Albulena Haxhiu, pasi njoftoi anëtarët e Komisionit për çështjen në fjalë, shtroi pyetjen në lidhje me ndonjë propozim të mundshëm nga ana e Komisionit, për përfaqësues të Komisionit qeveritar për njohjen e statusit të ish- të dënuarve dhe të ish- të përndjekurve politikë.

Nezir Çoçaj propozoi për përfaqësuese znj. Selvije Halimi.

Kryetarja, propozoi znj. Doruntinë Maloku.

Komisioni vendosi që për këtë pik është e nevojshme të bëhen konsultime shtesë dhe u vendos që kjo të shqyrtohet në një mbledhje të radhës.

6. Shqyrtimi i raporteve të komisioneve kryesore për Projektligjin për Mbikëqyrjen Elektronike të Personave të cilëve u kufizohet lëvizja më vendim të Gjykatës ose të Panelit për Lirim më Kusht;

Albulena Haxhiu, kryetare theksoi se përveç Komisionit për Buxhet dhe Financa, që në mbledhjen e mbajtur më 1.4.2015, e ka shqyrtuar Projektligjin nr. 05/L-03 për mbikëqyrjen

elektronike të personave, të cilëve u kufizohet lëvizja me vendim të Gjykatës ose të Panelit për lirim me kusht, dhe ka vlerësuar se Projektligji për mbikëqyrjen elektronike të personave, të cilëve u kufizohet lëvizja me Vendim të Gjykatës ose të panelit për lirim me kusht, përmban kosto buxhetore të përballueshme për Buxhetin e Republikës së Kosovës. Kurse Amendamentet e propozuara nga Komisioni Funkcional, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë. Komisionet tjera nuk kanë paraqitur ndonjë vërejtje dhe janë plotësuar kushtet që Raporti me amendamente të procedohet për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.

Kryetarja konstatoi se Komisioni njëzëri vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

Rekomandim

Komisioni i rekomandon Kuvendit që ta miratojë Projektligjin për Mbikëqyrjen Elektronike të Personave të Cilëve u Kufizohet Lëvizja me Vendim të Gjykatës ose të Panelit për Lirim me Kusht dhe amendamentet e propozuara.

7. Shqyrtimi i raporteve të Komisioneve Kryesore për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-51, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik;

Kryetarja Albulena Haxhiu, theksoi se Komisioni për Integritet Evropian, në mbledhjen e mbajtur më 24.3.2015, ka vlerësuar se Projektligji dhe amendamentet e propozuara nuk janë në kundërshtim parimet e përgjithshme të legjislacionit të Bashkimit Evropian. Ndërsa është kërkuar sqarim për amendamentin 5 dhe 6, dhe lidhur me këtë ajo tha se Komisioni për Integritet Evropian ka dal jashtë fushëveprimit të tij sepse në kompetencë ka vetëm vlerësimin për projektligjin dhe amendamentet, nëse janë në pajtim me parimet e përgjithshme të legjislacionit të Bashkimit Evropian. Arsyetimi për secilin amendament tani është përfshi në këtë raport, i cili procedohet për shqyrtim dhe miratim në një nga mbledhjet e Kuvendit.

Komisionet tjera nuk kanë paraqitur ndonjë vërejtje dhe janë plotësuar kushtet që Raporti me amendamente të procedohet për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.

Kryetarja konstatoi se Komisioni njëzëri vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

Rekomandim

Komisioni i rekomandon Kuvendit që ta shqyrtojë dhe miratojë Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-51, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik dhe amendamentet e propozuara.

Mbledhja përfundoi në orën 11:45.

E përgatiti:

Stafi Mbështetës i Komisionit.

Kryetarja e Komisionit,
Albulena Haxhiu